

STATUTI I SHOQERISE TREGETARE "ALBANIASERVICES360 "SH.P.K

Neni 1

Sot me date 21.01.2023 ne baze te Ligjit 9901 date 14.04.2008 " Per Shoqerite Tregtare" dhe ligjit nr.9723,date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",Ligjit Nr.131/2015 dt.26.11.2015"Per Qendren Kombetare te Biznesit" , 2(dy) ortaket themelues te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar e Emertuar "ALBANIASERVICES360 " Sh.p.k:

- 1- **Z. Ugo Cacciaglia** i dtl.11.07.1977 lindur në, San Giorgio a Cremano -NA, ITALI identifikuar me Karte Identiteti (ID) me Nr.CA93595EY,me zotesi te plote juridike per te vepruar.
- 2- **Z. LUCA ROMANO** i dtl. 04.06.1974 lindur ne Napoli,Itali i identifikuar nga Leternjoftimi(Pasaporte) me Nr.YB5736535,me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Neni 2

Shoqeria e ka Seline e saj ne Tirane, ne rrugen"Isa Boletini", pallati numer 6, kati i 2, apartamenti nr. 11.
Shoqeria mund te krijojë Qendra Sekondare, Filiale, Zyra Perfaqesimi e Agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose edhe jashte vendit.

NENI 3

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj me nje afat te pacaktuar.

NENI 4

Shoqeria do te kete statutin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe do te perballoje Humbje deri ne kufirin e kontributit te themeluesve te saj ne kapitalin themeltar.

NENI 5

Veprimtaria e shoqerise , marredheniet e saj me persona te trete juridike e fizik, vendas dhe te huaj shteteror dhe privat , rregullohen ne baze te Legjislacionit te Republikes se Shqiperise,Ligjit"Per Shoqerite Tregetare" si dhe akteve te tjera ligjore e nenligjore te dala ne zbatim te ketij legjislacioni.

Neni 6

Shoqeria vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper vete te gjitha te drejtat dhe detyrimet.

Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore dhe jashte kontraktore brenda kapitalit te saj .

Ortaku i vetem i shoqerise bart rrezikun e veprimtarise se shoqerise brenda nivelit te shumes se investuar.

OBJEKTI NENI 7

Objekti i veprimtarise se saj do te jete :

- qe eshte trajnimi universitar i te gjitha niveleve duke perfshire shkollat e specializimit dhe masterat pasuniversitar, trajnime qe synojne vendosjen ne pune; menaxhimin e shkollave te te gjitha niveleve;

- zhvillimi i turizmit ne Shqipëri nëpërmjet informacionit turistik, shitjes së paketave të pushimeve dhe gjithçkaje që sillet rreth tij, duke përfshirë marrjen me qira të makinave, motoçikletave dhe varkave;

- shitjen e pasurive të paluajtshme;

- konsulencë biznesi dhe/ose për profesionistë dhe/ose individë nga e gjithë bota të interesuar për transferimin ose hapjen e zyrave dytësore në Shqipëri.

- menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe/ose pjesëmarrjen në aktivitete tregtare të çdo lloji;

Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektit te saj duke perfshire edhe veprime per shitblerje sendesh te luajteshme dhe te paluajteshme, pjesemarrje me kuota dhe aksione ne shoqeri e ndermarje te tjera.

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 200.000 leke i formuar nga te 2(dy) ortaket e shoqerise Z. Ugo Cacciaglia dhe **Z.LUCA ROMANO**.

Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise eshte :

- **Z. Ugo Cacciaglia** , 1 pjese, 100.000 leke perkatesisht 50% te kuotave.

- **Z. LUCA ROMANO**, 1 pjese , 100.000 leke perkatesisht 50% te kuotave.

Ky kapital ndahet ne 2 pjese te . Numri i pergjithshem i kuotave eshte 2(dy).

Te gjitha kuotat e kapitalit themeltar jane te nenshkruara nga te 2(dy) ortaket e shoqerise , dhe do te paguhen pas Regjistrimit ne Q. K . B. te Shoqerise.

NENI 9

Kapitali i Shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas Vendimeve te Asamblese se Ortakut te vetem te Shoqerise por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar.

Aktiviteti ne kete shoqeri nuk e pengon Ortakun qe te kete te drejta pronesie jashte kesaj shoqerie.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e Ortakut jashte kesaj shoqerie.

Neni 10

Shoqeria eshte pergjegjese vetem per kapitalin dhe mjetet qe disponon dhe asgje me teper .

Neni 11

Bilanci dhe te Ardhurat.

Shoqeria percakton fondet e saj , fondin themeltar dhe ate rezerve .Gjate ushtrimit te veprimtarise mund te caktohen dhe fonde te tjera. Fondi Themeltar i Shoqerise formohet nga mjetet e investuara nga Ortaket e Shoqerise.

NENI 12

Kur Shoqeria pushon aktivitetin e saj , pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesa e mbetur e kapitalit dhe te ardhurat i mbeten teresisht Ortakeve te Shoqerise.

Neni 13

Veprimtaria Ekonomike dhe Financiare e Shoqerise mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore Administratori i Shoqerise nxjerr Bilancin Kontabel me Rezultatit Humbje – Fitim si dhe perpilon raportet perkatese me shkrim.
Bilanci Vjetor duhet te paraqitet brenda muajit mars te vitit pasardhes.

Neni 14

Te ardhurat neto , pas veçimit te fondeve te permendura me siper i mbeten ne perdorim shoqerise.

Neni 15

Organet e shoqerise jane :

- Asambleja e Ortakeve te Shoqerise.
 - Administratori qe eshte z. **Ugo Cacciaglia** e Z. Avv. Luca Romano.
- Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

Neni 16

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise eshte Organi Vendimor i Shoqerise, dhe Asambleja e Ortakeve te Shoqerise nepermjet vendimeve qe merr realizon te gjithë aktivitetin e veprimtarise se Shoqerise. Ajo percakton drejtimet kryesore vendos Bilancin Vjetor , per ndryshimet ne Statut , per pranimin ne Shoqeri te Ortakeve te tjere, te gjitha keto ne baze te ligjit per "Shoqerite Tregtare".

Neni 17

Me vendime te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise, lidhen kontrata me persona fizike dhe juridik shteteror e privat , vendas dhe te huaj si dhe

vendoset per drejtimet e aktivitetit te shoqerise. Asambleja e Ortakeve te Shoqerise vendos per fuqine punetore , per pagat e tyre duke lidhur me ta kontrata ne perputhje me ligjin.

Neni 18

Shoqeria mund te shperndahet me likuidimin e saj. Ne rastin e Likuidimit te Shoqerise , emertimi i saj do te pasohet nga shenimi " Shoqeri ne Likuidim e Siper".

Neni 19

Shperndarja e Shoqerise mund te vije per cfaredo arsye. Per kete Asambleja e Ortakeve te Shoqerise vendos per menyren e likuidimit te saj. Caktohet nje ose disa likuidator. Kjo ben kujdes qe shoqeria te likuidoje me pare detyrimet qe ajo u ka personave te trete fizike e juridike.

Neni 20

Kapitali i shoqerise kur vdesin Ortaket e Shoqerise u mbetet sipas ligjit mbi trashegimine, trashegimtareve te tyre ligjore , Shoqerine e trashegojne trashegimtaret e tyre ligjore .

Neni 21

Administratori ka te drejte te emeruje Kontabilist dhe Avokat si dhe te perfaqesoje shoqerine ne maredhenie me te tretet , ne pershtatje te plote me ligjin mbi perfaqesimin, ai kane nje mandat pese vjecar me te drejte ripertesitje te ketij mandati.

Neni 22

Shoqeria deklarohet e krijuar dhe fiton zotesine juridike me rregjistrimin e saj ne Qendren Kombetare te Biznesit .

Neni 23


Persa nuk eshte shkruar ne kete Statut i referohet plotesimeve nga vendimi i Asamblese se Ortakeve te Shoqerise si dhe ligjeve per "Shoqerite Tregtare".

Neni 24

Ky akt u perpilua ne prani te 2(dy) Ortakeve te Shoqerise duke shprehur vullnetin e tyre te plote e te lire. Akti u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarte secila, per t'u depozituar ne Qendren Kombetare te Biznesit e per t'u shperndare ne organet kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin e shoqerise


ORTAKET E SHOQERISE

UGO CACCIAGLIA



UGO CACCIAGLIA

LUCA ROMANO



LUCA ROMANO